



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zv.Ministri i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, bazuar në nenin 10,11 dhe 16 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), nenin 11 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Nenin 4.10 (shtojca nr.1.10) të Rregullores nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 53 dhe 59 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe nenin 21 të Ligjit për transportin rrugor Nr.04/L-179, bazuar në dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Nr.09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndërurban të udhëtarëve me autobus, nxjerr:

VENDIM

- I. **ANULOHE**t pjesërisht vendimi nr. 9857 i datës 28.12.2023 për aprovimin e kërkesës nr.8790 dhe 8791 date 16.11.2023 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "TOLI REISEN" shpk me seli në Pejë për marrjen e nisjeve në relacionin Pejë-Gurakoc- Istog me orare të nisjeve (07:45-08:45; 10:15-11:15; 13:00-PK; 12:45-13:45; 15:15- 16:15; 16:45-17:45) dhe nisjeve në relacionin Istog-Gurakoc-Pejë me oraret e nisjeve (09:30-10:30; 14:00-15:00; 16:00-17:00) përkatesisht anulohet (nisja Pejë-Gurakoc- Istog me orare të nisjes 16:45 dhe kthim 17:45).
- II. Pjesa tjetër e vendimit nr. 9857 i datës 28.12.2023 për aprovimin e kërkesës nr.8790 dhe 8791 date 16.11.2023 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "TOLI REISEN" shpk me seli në Pejë, mbetet në fuqi.
- III. Obligohet MMPHI-ja që të ndermarr veprimet e nevojshme ligjore për t'i kthyer tek operatori pagesat e realizuara nga operatori në fjale rreth kesaj nisjeje.
- IV. Obligohet Departamenti i Transportit Tokësor në zbatimin e këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës

Objekti "Gërnia", Rr. Nëna Terezë - 10.000 Prishtinë, Kosovë

<http://ëëë.mit-ks.net>

Arsyetim

Me vendimin nr. 9857 i datës 28.12.2023 për aprovimin e kërkesës nr.8790 dhe 8791 date 16.11.2023 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "TOLI REISEN" shpk me seli në Pejë për marrjen e nisjeve ne relacionin Pejë-Gurakoc- Istog me orare te nisjeve (07:45-08:45; 10:15-11:15; 13:00-PK; 12:45-13:45; 15:15- 16:15; 16:45-17:45) dhe nisjeve ne relacionin Istog-Gurakoc-Pejë me oraret e nisjeve (09:30-10:30; 14:00-15:00; 16:00-17:00), i cili është publikuar në web-faqen e MMPHI-së, në linkun "te njoftimet".

Gjatë zhvillimit të procedurës lidhur me shpalljen publike të nisjeve të lira në transportin ndërurban nëpër regjione, perkatesisht vertetimin e rendeve te udhetimit, Departamenti i Transportit Tokësor ka vërjetur se (nisja Pejë-Gurakoc- Istog me orare te nisjes 16:45 dhe kthim 17:45) është lëshuar një gabim teknik për faktin që kjo nisje eshte e verteuar nga MMPHI-ja tek nje oepreator tjetër sipas rendit te udhetimit nr.04/03/2023 me afat vlefshimmerie deri em daten 25.02.2026.

Prandaj sipas kompetences ligjore Zv.Ministri i Ministrise së Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktures **me rekomandim të komisionit profesional dhe** duke u bazuar në dispozitat e nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr vendim për anulimin e nisja Pejë-Gurakoc- Istog me orare te nisjes 16:45 dhe kthim 17:45.

te shpallura sipas vendimit nr.12010 i dates 13.11.2019.

Duke u bazuar në të lartëcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

Hysen Durmishi

Zv.Minister



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.

Ministria e Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës

Objekti "Gërmia", Rr. Nëna Terezë - 10.000 Prishtinë, Kosovë

<http://ëëë.mit-ks.net>